



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prilato Received / Delivered	12.07.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. In Prot. Prot. No.	Shtypje Printed Appendix	Sasia Quantity
SKAMSHICK	5767	2023	115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.809/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.809/2023 të datës 02.06.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Agjencia për Eficiencë dhe Energji-Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike-administrative “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.07.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vërejtja e datës 04.05.2023 e shqiptuar ndaj ankueses nga Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ.
- II. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankueses dhe të veprojë në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje vetëm ankuesja) më datë 02.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.809/2023, kundër Vërejtjes së datës 04.05.2023 e shqiptuar përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar është e paqëndrueshme, e pa arsyetuar juridikisht dhe profesionalisht dhe e mbështetur ekskluzivisht në qëndrim personal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Ekonomisë, ndërsa kjo e fundit më datë 09.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 02.06.2023 me Nr.Prot:4579/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të shqiptuar përmes e-mailit zyrtar të datës 05.04.2023; Provat shtesë nga ankuesja të datës 09.06.2023 në Këshill lidhur me vërejtjen e shqiptuar; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.06.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.06.2023 nga Ministria e Ekonomisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 31.03.2017 së bashku me formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen të datës 30.01.2023 dhe 31.01.2022; E-mailat zyrtar lidhur me komunikimet e datës 02.02.2022, 31.01.2022, 13.05.2022 ndërmjet ankueses dhe udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë; E-mailin zyrtar lidhur me komunikimet e datës 07.06.2023 ndërmjet udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses dhe udhëheqëses së burimeve njerëzore; Marrëveshjen për punën me vëllim të shtuar me Nr.Prot.755 të datës 01.03.2023; E-mailat zyrtar lidhur me komunikimet e datës 03.05.2023, 04.05.2023, 07.06.2023, 04.10.2023 ndërmjet Udhëheqësit të Divizionit për Planifikim, ankueses, zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë; Letër rekomandimin nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për ankuesen tek AKEE; Raportet e punës së Komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të subvencionimit të eficiencës së energjisë për qytetarët me Nr.Prot.1440 të datës 02.05.2023, Nr.1666 të datës 19.05.2023, Nr.Prot.1875 të datës 02.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankueses sipas ankesës me numër 809/2023 të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që ka nxjerr aktin administrativ të kontestuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtaret Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: *përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë se i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik*" andaj, sipas këtij përcaktimi ligjor rrjedhë se çdo nëpunës civil i cili pretendon se i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil nga veprimi administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) i organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtroj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 127 me të cilin është përcaktuar se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"* rrjedhimisht në kuptim të kësaj baze ligjore Kolegji i Këshillit konstaton së vërejtja e datës 05.04.2023 nuk përmban këshillën juridike, andaj në mungesë të këtij informacioni ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill me datë 02.06.2023 është e ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe se e njëjta sipas Akt emërimit të datës 31.03.2017 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Zhvillim*, në Sektorin për Planifikim.

Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses me datë 04.05.2023 përmes e-mailit zyrtar ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se ankuesja ka bërë shkelje të rregullave të parapara me nenin 46 paragrafin 4, nën paragrafët 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se vërejtja e shqiptuar është e paqëndrueshme, e pa arsyetuar juridikisht dhe profesionalisht dhe e mbështetur ekskluzivisht në qëndrim personal, gjë që nuk përbën argument juridik e as ligjor, po ashtu e njëjta ka theksuar se nuk është e vërtetë që ka shkelur kodin e etikës me sjellje dhe se lidhur me këtë çështje kërkon ballafaqim me fakte ngase për vërejtjen në fjalë ka dëshmitar komplet zyrën.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar më ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 me të cilin përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësitë e punës për pozitën që mban, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht, organi kompetent në realizimin e autoritetit publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mos diskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilat janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. ... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Rrjedhimisht, në kuptim të kuadrit ligjor si më sipër si dhe bazuar në vlerësimin e provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së masa disiplinore "Vërejtje" e datës 04.05.2023 është shqiptuar ndaj ankueses mbi bazën së e njëjta me datë 03.05.2023 ka pasur sjellje jashtë etikës dhe kodit të etikës me Kryeshëfin Ekzekutiv të Agjencisë për Efiçencë të Energjisë, duke u cilësuar si shkelje e lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafit 4 nën paragrafit 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa, bazuar në përgjigjen në ankesë mbikëqyrësi i ankueses ka arsyetuar se masa disiplinore "vërejtje" e datës .... është shqiptuar mbi bazën së ankuesja nuk ka respektuar nenin 4 të marrëveshjes së datës 01.03.2023 për punë më vëllim shtesë, nuk ka respektuar hierarkinë e komunikimeve brenda dhe jashtë institucionet, ka sjellje jo të mira të ankueses në raport me udhëheqësin e saj dhe Kryeshëfin Ekzekutiv, si dhe nuk ka respektuar orarin e punës. Pra, mbi bazën e këtyre rrethanave vihen në pah kundërthënie të fakteve lidhur me këtë çështje disiplinore përkatësisht masa disiplinore e goditur me ankesë nuk përshinë të gjitha shkeljet disiplinore siç pretendohet nga udhëheqësi i ankueses sipas shkresës të datës 07.06.2023, kështu që ekzistimi i këtyre fakteve pamundëson vendosjen meritore lidhur me këtë çështje disiplinore, rrjedhimisht duke qenë se masa disiplinore "Vërejtje" e datës 04.05.2023 e shqiptuar ndaj ankueses përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që çështja të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, me detyrimin që Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore dhe të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafit 3, 4, 5, dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *... "Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafit 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit. Përkatësisht mbikëqyrësi i ankuesit në rast të kualifikimit se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore duhet të shqiptoj masën disiplinore sipas nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ose në rast të kualifikimit se ankuesja ka bërë shkelje të rëndë disiplinore atëherë rastin duhet ta përcjell për Komisionin Disiplinor në pajtim me nenin 7 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.*

Theksuar si me lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u




bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.809/2023.**

Ardita Përcuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë për Eficiencë të Energjisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.